



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2363/11 Prot.

Datë 24.09.2024

V E N D I M
Nr. 1325 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e dates 24.09.2024, mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1221/2024, datë 10.09.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastrë
Adresa: Gjirokastrë

Ankimues: Operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F me Nipt. L42103023G dhe adresë: *Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.09.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1221/2024, ku vendosi:

1. *Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastër.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi Skualifikimin e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Nëpërmjet shkresës ardhur me nr. 7987/1 prot., datë 19.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2363/8, datë 23.09.2024, me objekt “Vënie në dijeni për zbatim vendimi” *Autoriteti kontraktor njofton mbi zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën sipërcituar.*

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Nëpërmjet shkresës ardhur me nr. 7987/1 prot., datë 19.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2363/8, datë 23.09.2024, me objekt “Vënie në dijeni për zbatim vendimi” *Autoriteti kontraktor njofton mbi zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastër.*

II.2. Referuar shkresës sipërcituar AK informon se: “Në zbatim të vendimit të KPP-së Autoriteti kontraktor më datë 18.09.2024 kreu rivlerësim të procedurës së prokurimit.”

Komisioni, referuar informacionit të autoritetit kontraktor kreu verifikimet në SPE dhe konstatoi se AK ka kryer rivlerësimin e ofertave më datë 19.09.2024 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në përputhje me konstatimet e vendimit të Komisionit për procedurën sipërcituar.

II.3. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 1221/2024, datë 10.09.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligji nr. 162/2020 «Për Prokurimin Publik», i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 12.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

